

FALEMINDERIT që ti riciklon!

Albanska



Çdo herë kur lë një ambalazh apo një gazetë për t' u ricikluar, ndodhë diçka e madhe. Kapaku i vjetër shndërrohet në vidhë. Pakoja e palosur e pluhurit të rrobave bëhet kuti e mirë kartoni këpucësh. Gazeta e lexuar bëhet një gazetë e re për të lexuar. Në këtë mënyrë, ti ndihmon të kursehet sasi e madhe e energjisë. Kështu kujdesesh që lëndët e para të natyrës mos të bien nga ciklimi. Falë kujdesit tënd, mjedisi fiton shumë. Me këtë fiton edhe ti diçka. Çdo herë që ti riciklon.

Ambalazhet dhe gazetat në një ciklim

Të gjitha ambalazhet dhe gazetat të cilat grumbullohen, dërgohen për riciklim, për t' u bërë ambalazhe ose prodhime të reja. Ambalazhet nga plastika mund të bëhen rrethojë dhe furça për larje të enëve si dhe saksi lulesh dhe qese plastike. Qelqi dhe ambalazhi i letrës, para së gjithash, bëhen ambalazhe të reja. Ambalazhet e metalit mund të bëhen binarë hekurudhe. Gazetat e lexuara mund të bëhen letër kuzhine.

Përgjegjësia e prodhuesit

Qeveria ka vendosur që çdo ndërmarrje që prodhon, importon, mbush ose shet ambalazhe ose mall të ambalazhuar, duhet të ketë përgjegjësi për një sistem të grumbullimit, ku konsumatorët mund t' i lënë ambalazhet për riciklim. Kjo quhet përgjegjësi e prodhuesit. E njëjta gjë vlen për gazetat dhe letrën kthyese. Ata të cilët prodhojnë ose importojnë letër për gazeta dhe shtypin ose importojnë gazeta, duhet po ashtu të kenë përgjegjësi për grumbullimin dhe riciklimin e letrës kthyese. Ambalazhet dhe gazetat janë dy grupet e para të mallit, për të cilat është aplikuar përgjegjësia e prodhuesit. Prodhuesit e ambalazheve dhe gazetave e kanë zgjidhur këtë përgjegjësi përmes grumbullimit të ambalazheve dhe të gazetave (sued. FTI), veprimtari e cila zhvillohet pa qëllim përfitimi.

Stacionet e riciklimit

FTI përgjigjet për të gjitha stacionet e grumbullimit, rreth e përqark Suedisë. Atje shkon për të lënë gazetat dhe ambalazhet e plastikës, letrës, metalit dhe qelqit, për riciklim. Nëse ti banon në një shtëpi me grumbullim të tij të gazetave dhe ambalazheve, i lë ato aty. FTI bashkëpunon me shumicën e sipërmarrësve kontraktues që i marrin aty. Kjo është garancia jote që gjithçka riciklohet, po në atë mënyrë.

Më shumë informacion

Në uebfaqen tonë www.ftiab.se/hitta-atervinningsstation mund të gjesh stacionin më të afërm të riciklimit dhe të shohësh të dhënat kur ai zbrazet herën tjetër dhe kur pastrohet. Këtu ekzistojnë edhe udhërrëfyes klasifikimi, filma mbi riciklimin, këshilla dhe informacion mbi veprimtarinë tonë.

Ti, po ashtu, mund të na kontaktosh përmes e-postës info@ftiab.se ose telefonit 0200-88 03 11 e të marrësh përgjigje në pyetjet tua.

Kur bëhet fjalë për mbeturinat tjera si bërllok i trashë, grumbull mbeturinash, mbeturina elektrike dhe mbeturina të rrezikshme, për këtë përgjigjet komuna jote.



Kështu i klasifikon:

Të gjitha ambalazhet duhet të jenë të zbratura dhe të thara/mos të pikojnë. Ambalazhet e materialeve të ndryshme duhet të veçohen/ndahen. Nëse nuk mund të ndash materialin, e klasifikon ambalazhin sipas materialit dominues përbërës.



AMBALAZHET PLASTIKE

Shembull: shishe, kavanoz, kova të vogla dhe bidonë, qese bartëse plastike, qese plastike rul (p.sh. fruta dhe gjëra të gjelbra në shitoren ushqimore), pako rimbushëse, tub, qese çipësi dhe frigolit.

Bë kështu Heq tapat dhe kapakët Zbraze qesen tënde me ambalazhet plastike në kuti që ato të shtrihen veç e veç. Kjo e lehtëson më vonë punën e riciklimit.

Mos e lë Prodhimet plastike të cilat nuk janë ambalazhe, ato lihen si mbeturina të trasha të amvisërisë, p.sh. mobile, lodra dhe videokaseta. Shishe kthyese lihen si peng në shitore.



AMBALAZHE LETRE

Shembull: pako paste, qumështi dhe lëng pemësh, qese bartëse letre, qese sheqeri, kuti kartoni këpucësh, rul tualeti dhe kuti kartoni.

Bë kështu Rrafshoje dhe e palos. Futi ambalazhet e vogla në ato më të mëdha, për të kursyer hapësirë transporti.

Mos i lë Zarf lihen në mbeturina të amvisërisë/të djegshme. Gazetat, fletë reklamash e të ngjashme, lihen në kuti për gazeta.



AMBALAZHET METALIKE

Shembull: kanoçe konservash dhe tub spreji të liruar nga vërshëllima, tubat, tapat dhe kapakët, kuti e penel ngjyre të tharë.

Bë kështu Lakoj brenda kapakët e mprehtë të kanoçeve të konservave. Lëre tapën e kutive të rri aty.

Mos lë Kutit me ngjyrë dhe mbetje ngjitësi, lihen si mbeturina të rrezikshme. Skrap metali, detaje instalimi të ujit, tiganë dhe prodhime të tjera, që nuk janë ambalazhe, lihen si mbeturina të trasha ose të amvisërisë. Kanoçe kthyese lihet si peng në shitore.




AMBALAZHE QELQI

Shembull: shishe dhe kanoçe nga qelqi i ngjyrosur ose i pa ngjyrosur.

Bë kështu E heq tapën, kapakun dhe tapat dhe i klasifikon ato për riciklim, sipas materialit. Lë ambalazhet e qelqit të ngjyrosur ose të pa ngjyrosur në kontejnerin përkatës.

Mos lë Shisheet kthyese lihen si peng në shitore. Porcelan, qeramikë dhe prodhimet e tjera, që nuk janë ambalazhe, lihen si mbeturina të mëdha ose mbeturina amvisërie. Llamba ndriçimi dhe gypa neoni, lihen zakonisht në qendrat komunale të riciklimit.



GAZETA

Shembull: gazetat ditore dhe ato javore, revistat, katalogët, fletë reklamash, broshura si dhe letër për shkrim dhe vizatim, libra xhepi.

Bë kështu Heq qeset plastike dhe copa letrash të ngjitura me reklama, para se të lihen gjërat e shtypura në kontejner.

Mos lë Zarfe dhe libra të lidhura lihen në mbeturinat e amvisërisë, të djegshme. Qese letre bartëse, kartonë e të ngjashme, lihen në kontejnerin për ambalazhet e letrës.